

Fleta e të dhënave të produktit
Botimi 27/10/2015
Nr. i identifikimit: 011402021000000006
Kodi: 09.02.020
Sika® Rapid+

Sika® Rapid+

Llaç me tharje të shpejtë gati për përdorim

Përshkrimi i produktit

Sika® Rapid+ është llaç me tharje të shpejtë, gati për përdorim, bazuar në një përzierje lidhësish (binders) dhe agregatesh të përzgjedhura, dhe karakterizohet nga zhvillimi i shpejtë i rezistencave mekanike të larta.

Përdorime

Sika® Rapid+ është llaç gati për përdorim, me qëllim përdorimi në të gjitha rastet ku kërkohet tharja e shpejtë, si:

- Fiksim konsolash, tapash, tubash
- Instalim i dyerve dhe dritareve të blinduara
- Ankorim kunjash, hunjsh, thurimash, gjerdhesh

Karakteristika/Avantazhe

- Thahet pas disa minutave
- Ambalazh praktik, gjithashtu i përshtatshëm për aplikime të vogla
- Tharje e shpejtë edhe në kushte të lagështa
- Mund të lyhet pas tharjes
- Ndërkapje e fortë tek metalet

Të dhënat e produktit

Forma

Paraqitja/ Ngjyra

Pluhur gri

Ambalazhi

qese 5 kg (5 qese për kuti)
thes 25 kg

Magazinimi

Kushtet e magazinimit/ Jetëgjatësia

8 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet saktë në ambalazhin origjinal të padëmtuar, të pahapur dhe të vulosur në kushte të thata dhe të freskëta.

Të dhëna teknike

Baza kimike

Materiale hidraulike lidhëse me rezistencë të lartë, agregate të përzgjedhura dhe aditivë kuarci, mineralë dhe organikë.

Uji i përzierjes

19-21% e peshës të produktit
0.95-1.05 Lt uji për qese 5 kg
4.75-5.25 Lt uji për qese 25 kg

Vetitë mekanike/ fizike

Rezistenca ndaj ngjeshjes pas 3 orësh

~ 6 MPa (EN 196-1)

Rezistenca ndaj ngjeshjes pas 28 ditësh

~ 24 MPa (EN 196-1)



Koha e punës*	~ 1-2 min
Koha e tharjes*	~ 2-3 min
Koha e pritjes për funksionim të plotë*	~ 2 orë

* Koha i referohet +23°C/ 50% lagështi relative. Koha është më e shkurtër në temperatura të larta dhe më e gjatë në temperatura të ulëta.

Informacione mbi sistemin

Detaje aplikimi

Konsumimi	Në varësi të ashpërsisë së nënshtresës, profilin të sipërfaqes dhe trashësisë së shtresës së aplikuar. Si udhëzim, ~ 1,8 kg pluhur për lt e mbushjes së vëllimit
Cilësia e nënshtresës	Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe të jetë e pastër, pa grimca të lira dhe pjesë të shkrifëta, kore çimentoje, vajra dhe graso apo ndotje të tjera.
Përgatitja e nënshtresës/ Lyerja me prajmer	Nënshtresa duhet të pastrohet dhe të ashpësohet lehtësisht me mjete mekanike. Sipërfaqja duhet të jetë njomur deri në ngopje, duke shmangur mbledhjen e ujit.

Kushtet e aplikimit/ Kufizime

Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +30°C max.
Temperatura e ambientit	+5°C min. / +30°C max.

Udhëzime aplikimi

Metoda e aplikimit/ Mjetet	Sika® Rapid+ duhet të shtyhet shpejtë në hapësirën për mbushje, duke ushtruar presion të madh për të siguruar ndërkapje të mirë. Mbani në vend objektin i cili duhet fiksuar, derisa llaçi të fillojë të thahet dhe është i aftë për të mbartur peshën e vet.
Mirëmbajtja e mjeteve	Heqja e mbetjeve të freskëta nga pajisja apo mjetet e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materialet e ngurtësuara/ thara mund të hiqen vetëm mekanikisht.
Shenime mbi aplikimin/ Kufizime	<ul style="list-style-type: none"> ■ Gjatë aplikimit në temperatura të larta (25-30°C): përdorni ujë të ftohtë për të ruajtur kohën e punës. ■ Gjatë aplikimit në temperatura të ulëta (5-8°C): përdorni ujë të ngrohtë për të lejuar ngurtësimin e shpejtë të llaçit. ■ Përziemi sasinë e produktit që mund të përdoret brenda 2-3 minutave ■ Mos shtoni asgjë tjetër tek pluhuri përveç ujit ■ Mos shtoni ujë në llaçin që ka filluar të thahet.

Baza e vlerave të matshme	Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.
----------------------------------	--

Kufizime lokale	Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.
------------------------	---

Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë	Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.
--	---

Shënime ligjore

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
Rruga Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Building no. 5,
9th floor, Office 91,
Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
alb.sika.com